

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rezultatet e PISA-s/ Mariana Koçeku: Janë të manipuluar! Shkollat e fshatrave nuk u përfshinë në test
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/11/rezultati-i-pisa-s-mariana-koceku-jane-te-manipuluara-shkollat-e-fshatrave-nuk-u-perfshine-ne-test/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 06:44:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 06:38:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ff89afc0b1f5c11f4507d19717aa0e9ba93683ce2cc0c115c9a548137021b4e3
TEKSTI	9ef8f4003295da3adedb79ffe063ef2e581f9da8f0c7db7fba2c3c3f1d0278d9
PAMJA	c028648ae0e44be2595912c96e7dac3c96ae0c32a7f0e62c79c484f4b98f97fd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	31f7ddb168063db1df3be0166680da9bb0b18e8966746b2fe5336b524304519f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f277981139be53bb46f8ef9e43e8e715f250cf75fe13d996c65e71b54da6516b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/31f7ddb168063db1df3be0166680da9bb0b18e8966746b2fe5336b524304519f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Rezultatet e PISA-s/ Mariana Koçeku: Janë të manipuluara! Shkollat e fshatrave nuk u përfshinë në test

08:38 : 11/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Shqipëria është renditur e para në rajon sipas rezultateve të fundit të PISA-s, me një rritje të ndjeshme të pikëve në matematikë, shkencë dhe lexim. Por deputetja Mariana Koçeku ka ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si janë përfshirë këto rezultate, duke argumentuar se një pjesë e konsiderueshme e shkollave shqiptare nuk janë përfshirë në testim.

Në një postim në rrjetet sociale, Koçeku shkruan se Shqipëria ka shënuar 65 pikë më shumë në matematikë, 59 pikë në shkencë dhe 50 pikë në lexim, duke u renditur e para në rajon.

Sipas Koçekut, vetëm 76% e shkollave kanë marrë pjesë në testim, ndërsa standardi i kërkuar është 85%. Po ashtu, shkollat me më pak se 21 nxënës nuk janë përfshirë në testim.

"Ministria e lexoi qartë prej Bratislavës: plus 65 pikë në matematikë, plus 59 në shkencë, plus 50 në lexim. Dolëm të parët në rajon në renditje. PISA asht testi ndërkombëtar që mat aftësitë e nxanësve 15-vjeçarë në matematikë, shkencë dhe lexim. Por në tabelën e rezultateve, OECD-ja, organizata që e zhvillon testin – i ka vendosë Shqipnisë një yll. Dhe ai yll tregon se rezultatet mundën me qenë të manipulueme. Vetëm 76% e shkollave morën pjesë, ndërkohë që standardi i kërkuar asht 85%. Shkollat me ma pak se 21 nxanës nuk u përfshinë aspak në testim. Këto shkolla janë shpesh ato të zonave rurale, të komuniteteve ma të vogla e ma të braktisuna, aty ku mundësitë për arsim cilësor kanë qenë historikisht ma të pakta.

Prandaj nuk e di për çka flasim kur festojmë rezultatet e PISA-s", - shkruan Koçeku.

Koçeku argumenton se pikërisht këto shkolla ndodhen shpesh në zona rurale dhe komunitete të vogla, ku problemet dhe vështirësitë në arsim janë më të mëdha. Ajo thotë se rezultatet e nxënësve që kanë marrë pjesë në PISA nuk duhen zhvlerësuar nëse janë realisht të mira, por kundërshton paraqitjen e tyre si pasqyrë e plotë e arsimit shqiptar. Sipas saj, vëmendja nuk duhet të përqendrohet vetëm te renditja në testet ndërkombëtare, por edhe te kushtet në të cilat zhvillohet arsimi në vend.

Lexo edhe:

TË GJITHA



Rezultatet e PISA-s/ Mariana Koçeku: Janë të manipuluara! Shkollat e fshatrave nuk u përfshinë në test

08:38 : 11/09/2026



Këmbimi valutor 11 shtator, me sa shiten e blihen sot monedhat e huaja

08:29 : 11/09/2026



Një vilë në këmbim të tenderit/ Si e fshehu Balluku pronën e dytë në Palasë

08:10 : 11/09/2026



Kthjellime dhe vranësira, si parashikohet moti për ditën e sotme

08:01 : 11/09/2026



Horoskopi/ Nga krizat në dashuri te surprizat e mëdha, çfarë parashikojnë yjet për 12 shenjat

23:00 : 10/09/2026



Trafik armësh? Puca 'kyç gojën', por mbron partneritetin me Yeffet dhe KAYO: Duam të zgjerohemi

22:49 : 10/09/2026



Trafik armësh përmes Shqipërisë?/ Përgjimet e Ahmetajt për KAYO-n, Velu: Fabrikat tona kanë zero prodhim...

22:47 : 10/09/2026

Rezultati i PISA-s/ Studiuesi: Të dhënat e Shqipërisë me sinjal të kuq! Dyshohet se janë fasifikuar

Marjana Koçeku largohet nga rreshti i PS, i bashkohet deputetëve të opozitës

“Kur fëmijët ende sot ecin me nga një orë në kambë për me mbërritë në shkollë, kur mësuesit paguhen ma pak se një kamarier, kur shkollat funksionojnë në kushte mjerimi e fshatnat veç zvogëlohen, dobësohen e tjetërsohen, asht vështirë me besu në këto statistika preferenciale. Nji rezultat vërtet i mirë i PISA-s për Shqipërinë kishte me qenë: ma pak shkolla në kushte mjerimi dhe ma pak fëmijë që e kanë sfidë arsimin qysh para se me hy në klasë”, - shkruan ajo ndër të tjera.

Etiketa: Marjana Koçeku pisa Shqipëria

Lajme të lidhura



Rezultati i PISA-s/ Studiuesi: Të dhënat e Shqipërisë me sinjal të kuq! Dyshohet se janë fasifikuar

13:35 : 09/09/2026



Marjana Koçeku largohet nga rreshti i PS, i bashkohet deputetëve të opozitës

20:08 : 08/09/2026



“Asterisku që shfryn propagandën/ Boçi për PISA: Standardet e kampionit nuk janë përmbushur

18:04 : 08/09/2026



PISA publikon rezultatet e 2025, Shqipëria mund të ketë trukuar testin

11:52 : 08/09/2026



Shqipëria kampione për "Ilaç e tulla", por mbetet e treta në Europë për privimin e rëndë nga strehimi

08:00 : 09/09/2026



11 vatra zjarri aktive në vend, Dajti, Bardhaj dhe Fieri nën flakë

11:24 : 06/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

